



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Përmbledhje mujore e aktiviteteve nga IPK – Gusht 2026

Menaxhimi i ankesave

IPK gjatë muajit Gusht 2026 ka pranuar dhe ka menaxhuar me 281 ankesa. Prej tyre 206 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës në Policinë e Kosovës, disa janë përcjellë në institucione tjera kurse 75 nga to janë përcjellë në Departamentin e Hetimeve në IPK më dyshimin për veprimtari penale.

Gjithsej

Për javë

Për ditë

Numri i ankesave

281

70

9

Aktivitete në fushën e hetimeve

Bazuar në mandatin e paraparë me legjislacionin në fuqi, IPK kryen hetime penale dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë. Gjatë muajit Gusht 2026 Departamenti i Hetimeve në IPK ka pranuar 75 raste për hetim penal dhe në kuadër të autorizimeve ligjore ka dhënë rekomandimin për suspendim në interes të hetimit për 6 punonjës të Policisë së Kosovës dhe ka arrestuar 2 të dyshuar.

Aktivitetet e këtij Departamenti janë shprehur në mënyrë tabelore si në vijim:

Indikatori (numri)	Të dhëna për muajin Gusht 2026
Kallëzime penale të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	5
Raporte të veçanta të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	2
Raporte informuese të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	9
Raste të proceduara në DHB, DPP-PK dhe Arkiv-IPK	32
Rekomandime për suspendim	6
Të arrestuar	2

Aktivitete në fushën e inspektimit

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese. Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore përmes inspektimeve.

Gjatë muajit Gusht 2026 inspektorët e IPK-së kanë qenë të angazhuar në këto inspektime:

Fusha e inspektimit	Lloji	Statusi
Menaxhimi i Qendrës së Ndalimit në Stacionin Policor të Rahovecit	Jashtëzakonshëm	Final
Kompensimet për orët jashtë orarit të rregullt të punës	Jashtëzakonshëm	Final
Vlerësimi i performancës së stacioneve policore	I rregullt	Në proces
Inspektimi i trajtimit dhe efektivitetit të hetimit të rasteve të vjedhjeve (Hani i Elezit)	Jashtëzakonshëm	Në proces